



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN PËR SISTEMET ZGJEDHORE**

*25 shtator 2019*

E nderuar znj. Hajdari, i nderuar z. Gjicknuri, i nderuar z. Kaso, të nderuar ekspertë ndërkombëtarë, të nderuar përfaqësues të partive politike!

Po e nis këtë konferencë me shpresë dhe disi me besim. Procesi i reformës zgjedhore në Shqipëri duhet të vijojë dhe Prezenca e OSBE-së ofron një vend për dialog, ku të gjitha forcat politike të vijojnë dhe të përmbyllin këtë proces kyç. Më vjen mirë që shoh se ajo pjesë e opozitës që doli nga parlamenti gjendet sot në këtë dialog të rëndësishëm, këtu në panel, dhe shpresoj se ky është një premtim për t'u bërë pjesë e një procesi konstruktiv.

Vendi ka nevojë për dialog dhe bashkim, në prag të marrjes së Kryesisë së Radhës të OSBE-së vitin e ardhshëm. Por kjo është e rëndësishme edhe nga një pikëpamje më e afërt. Dje, parlamenti gjerman mori një mocion, i cili ngarkon me shumë përgjegjësi parlamentin shqiptar dhe partitë shqiptare. Ai mbështet hapjen e negociatave me BE-në, por kërkon që konferenca e parë për pranimin të zhvillohet vetëm kur, mes të tjerash, të vendoset një reformë zgjedhore, gjë që është në përputhje me rekomandimin e OSBE/ODIHR-it. Po ashtu, mocioni rekomandon që ky diskutim dhe kjo vendimmarrje të zhvillohen përmes një dialogu të hapur dhe përfshirës.

Vitin e shkuar pamë përparim dhe bashkëpunim të dukshëm në Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Kjo ishte një nga të paktat fusha ku të gjithë aktorët politikë vërtet bashkëpunuan. Gjithçka mori fund në fund të vitit të shkuar. Deri në atë çast, kontributet e të gjitha krahëve ishin për t'u vlerësuar, pra ishin ofruar në mënyrë konstruktive dhe ishin të mira nga pikëpamja teknike.

Ju do të diskutoni sot se si një sistem i ri zgjedhor mund të kontribuojë në hapjen, përfshirjen, transparencën, llogaridhënien dhe përfaqësimin. Kjo është ajo çka pres nga të gjitha partitë: të ofrojnë propozime konkrete, të shkojnë përtej këtij kthimi të lavdërueshëm në dialog, dhe të lënë pas deklaratat retorike, duke i zëvendësuar ato me propozime konkrete. Një gjë e tillë do të ishte e mirëpritur.

Pra, shpresoj se kjo konferencë do të ngjallë edhe njëherë procesin.

Në lidhje me diskutimin për ndryshimin e sistemit zgjedhor, kjo është një zgjedhje që u takon partive në Shqipëri. Janë ato që vendosin. Çdo forcë politike ka të drejtën ta shtrojë këtë çështje për diskutim. Demokracia funksionale mbështetet në kundërshtimin konstruktiv dhe në pjesëmarrjen përfshirëse.

Sikurse thotë titulli i konferencës, sistemi zgjedhor në Shqipëri nuk duhet t'i mohojë asnjë forcë politike hyrjen në parlament, apo të mos krijojë pengesa shumë të larta për këtë dhe,

nga ana tjetër, nuk duhet t'u mohojë qytetarëve shqiptarë të drejtën e përfaqësimit të gjerë e të drejtë të interesave të tyre.

Ne si Prezencë e OSBE-së në Shqipëri dhe miqtë tanë të ODIHR-it mund të ofrojmë ekspertizë në marrjen e këtij vendimi të rëndësishëm. A duhet Shqipëria ta ndryshojë sistemin e saj zgjedhor apo jo? Ky është vendimi juaj. Ne mund të ndihmojmë duke vënë në pah të mirat dhe problemet e sistemeve të ndryshme zgjedhore. Por ne nuk rekomandojmë asnjë sistem specifik dhe, sigurisht, nuk imponojmë ndonjë syresh.

Në të njëjtën kohë, të mos harrojmë pritshmëritë e larta me të cilat përballeni sa u takon ndryshimeve në Kodin Zgjedhor bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Këto janë procese paralele për të cilat jeni përgjegjës ndaj vendit tuaj.

Kjo konferencë është një mënyrë e mirë për të nisur këtë diskutim të rëndësishëm.

Së fundmi, kam një lutje: ju lutem, përmbajuni temës dhe lini mënjane deklaratat e përgjithshme politike. Përdoreni mundësinë e sotme për të folur për reformën zgjedhore, me theks te sistemi zgjedhor.

Shumë faleminderit për vëmendjen!